

M. Rrapaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2118/3 Prot.

Vlorë më, 15.11.2023

VENDIM
Nr. 40, datë 15.11.2023

PËR
MIRATIMIN E PLANIT VJETOR 2024 DHE PLANIT STRATEGJIK 2024-2026 TË
SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM TË UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE


Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 13, nenit 25 të Statutit të UV-së Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Udhezimit nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Auditit të Brendshëm nr.1694/1 prot, datë 16.10.2023, në mbledhjen e datës 15.11.2023 Bordi i Administrimit ,

VENDOSI

1. Të miratoje sipas shkresës 1694/1 prot, datë 16.10.2023:
 - Planin vjetor për 2024
 - Planin strategjik për vitet 2024-2026
2. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi gjendet plani vjetor dhe plani strategjik i Sektorit të Auditit të Brendshëm të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Auditit të Brendshëm në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Shtet NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM**

Nr. 1694 prot

Vlorë, më 16.10.2023

Lënda: Miratim plani strategjik 2024-2026, plan vjetor 2024

BORDIT TË ADMINISTRIM-IT

KËTU

Në zbatim të shkresës nr 1694 prot, datë 25.09.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm po ju përcjellim për miratim :


- Planin Strategjik 2024-2026
- Planin vjetor për vitin 2024

për sektorin e Auditit të Brendshëm në Universitetin "Ismail Qemali"
Vlorë.(bashkangjitur materiali)

Ju faleminderit për bashkëpunimin!


Përgjegjës Sektori

Marjanthi Rrapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SEKTORI I AUDITIT TE BREND SHEM

PLANI STRATEGJIK 2024-2026
dhe
PLANI VJETOR 2024
PËR
AUDITIMIN E BREND SHËM NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL-QEMALI”, VLORE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSDHEM

Hyrje:

Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", e urdhrit Nr. 100, datë 25.10.2016 'Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik', dhe përgjegjësi e Drejtuesit në njësinë e auditimit për hartimin, miratim tek Titullari i njësisë dhe më pas dërgimin për informim në Strukturën Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave.

Plani strategjik 2024-2026 "Për Auditimin e Brendshëm në Universitetin "Ismail-Qemali", Vlorë, është dokumenti i cili përcakton drejtimit në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut për fushat/sistemet të cilat mbulon ky funksion.

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për Titullarin e Universitetit "Ismail-Qemali" Vlorë, në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Universitet.

Universiteti Vlorë është institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale, dhe transferimin e dijeve të tërë. Ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve dhe të shkencës, inovacionit dhe të profesioneve.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, përbëhet nga njësitë kryesore (4 fakultetet), njësitë bazë (departamentet), Qendra Kërkimore-Shkencore, Shkolla e Masterit dhe Doktoraturës, laboratorët, bibliotekat, qendrat dhe njësitë e tjera ndihmëse dhe administrative.

Spektori Auditit të Brendshëm (AB) është pjesë e strukturës administrative të Universitetit "Ismail-Qemali" Vlorë, por është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë te Bordi Administrimit.

I. QËLLIMI DHE MISIONI I PLANIT STRATEGJIK

Plani strategjik "Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm" është një nga elementët e kontrollit për të siguruar që të gjitha veprimtaritë dhe operacionet e subjekteve mbulohen nga funksioni i auditimit të brendshëm. Plani strategjik i AB ka për qëllim të programojë punën që do të ndërmerret nga struktura e auditit të brendshëm të UV për periudhën e ardhshme 2024-2026. Në këtë plan do të programohen veprimtaritë kryesore që do të kryhen në vitet 2024-2026, për të siguruar që sistemet apo fushat e identifikuar me risk mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe 3 vjeçare.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave 3- vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të sektorëve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive me bazë risku.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BREND SHEM

Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet cdo vit, në kohën kur do të hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Frekuenca e auditimit është përcaktuar duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron funksionin e auditimit gjatë implementimit të tij.

Misioni

Misioni i njësise së Auditimit të Brendshëm në Universitet është të përmisojë veprimtaritë e institucionit, duke ndihmuar në arritjen e objektivave, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmisuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes në njësinë e Uv-së.

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektive synon të ndihmojë strukturat e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë të përmbushin objektivat e tyre.

Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje Universitetit në arritjen e objektivave :

- a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar ;
- b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
 - identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e riskut;
 - përputhshmërinë e veprimtarisë së njësise publike me kuadrin rregullator
 - ruajtjen e aseteve;
 - përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
 - kryerjen e veprimtarisë së njësise publike me efektivitet dhe efijencë;
 - besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësise publike;
- d) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në kryerjen e misionit, specialistët e njësise së auditimit mbështeten në parimet e ligjshmërisë, pavaresisë, paanësisë, fshehtësisë dhe në standartet e auditimit të brendshëm të emetuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe sipas ***Institutit te Auditorëve të Brendshëm të IIA-së.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSTEM

Bashkëpunimi me të gjithë strukturat, për të marrë informacionin e duhur, për zbatimin e rregullave dhe detyrave të çdo punonjësi në Universitetin "Ismail-Qemali", Vlorë, për të arritur në ekzaminimin dhe vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe efektivitetin e sistemit të organizuar të kontrollit të brendshëm dhe cilesinë e kryerjes me përgjegjësitë e caktuara, mbetet detyrë permanente që i shërben një planifikimi të bazuar në risk si dhe për një realizim më efektiv të angazhimeve.

Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, i jep menaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve, këshillime të pavarura, konfidenciale, për përdorimin me efektivitet, efëcence dhe ekonomi të burimeve.

II. ORGANIZIMI I NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE KUADRI LIGJOR

Organizimi i NJAB


Njësia e auditimit të brendshëm në Universitetin "Ismail-Qemali", Vlorë është organizuar në nivel sektori në varësi të Bordit të Administrimit dhe është e përbërë nga përgjegjësi i njësise dhe dy specialist :

1. Përgjegjësi i njësise (ekonomist)
2. Specialist (jurist)
3. Specialist (ekonomist)

Kuadri Ligjor Organizativ i Auditimit të Brendshëm

a. Kuadri Kombëtar i Auditimit të Brendshëm

- ✓ Në ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", botuar në fletoren zyrtare nr.195 , datë 13.09.2015
- ✓ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"
- ✓ Në urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik",
- ✓ Në urdhrin e Ministrit të Financave nr.86, datë 10.12.2015, "Për miratimin e Koditit të Etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik",



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I AUDITIT TË BREND SHEM

b. Kuadri Ndërkombëtar

Kuadri i Praktikave Profesionale Ndërkombëtare i cili përmban standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikat Profesionale të publikuara nga IIA (Instituti Auditorëve të Brendshëm), përbëjnë bazën e paketës ndërkombëtare të zbatueshëm për Auditimin e Brendshëm në Shqipëri.

c. Kuadri Ligjor i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë


- Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,
- Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, miratuar me Urdhër nr, 197, datë 01.04.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Vendimin e Senatit Akademik nr.8 datë 14.02.2018 "Për strukturën organizative të UV-ës", i ndryshuar; Vendimin e Senatit Akademik nr. 09.04.2018 "Për organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BREND SHËM

Objektivi strategjik i funksionit të auditimit të brendshëm është : të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në terma të efijencës, ekonomisë dhe efektivitetit.

Në mënyrë me specifike objektivat janë:

- 1) Dhënien e sigurisë tek Titullari, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga struktura e menaxhimit;
- 2) Dhënien e sigurisë objektive, që risqet janë identifikuar, vlerësohen dhe menaxhohen nga strukturat përgjegjëse;
- 3) Përdorimi i metodologjive bashkëkohore të Auditimit në përputhje me standartet e pranuar ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave më të mira të Njesisë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave;
- 4) Sigurimin për Titullarin se sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme për të parandaluar gabimet, abuzimet, shpenzimet e tepërta, të zbulojnë devijimet ndërmjet normave dhe realitetit, të përmiresojnë situatën ekzistuese dhe të ndihmojnë për arritjen e objektivave të caktuara për objektet që auditohen;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSHEM

- 5) Për të minimizuar mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim;
- 6) Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të objektivave të tij duke rekomanduar praktikrat më të mira për krijimin e rregullave dhe proceduarve specifike për cdo proces pune .

IV.IDENTIFIKIMI I SUBJEKTEVE

Duke u bazuar në organizimin e Universitetit "Ismail-Qemali", Vlorë, subjektet e identifikuar për auditim janë :


- Rektorati
- Fakulteti Ekonomisë
- Fakulteti Shkencave Teknike dhe Natyrore
- Fakulteti Shkencave Humane
- Fakulteti Shëndetit

V. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE/SISTEMEVE PRIORITARE

Me qëllim realizimin e auditimit me bazë risku mbetet i nevojshëm përcaktimi dhe identifikimi i sistemeve.

Për subjektet e identifikuar që do t'i nënshtrohen auditimit janë planifikuar auditime përputhshmërie, auditime financiare, auditime performance dhe auditime të kombinuara në fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve për cdo strukturë në përputhje me funksionet dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe objektivat e vendosura nga Universiteti. Sistemet e identifikuar janë :

1. Sistemi programimit dhe zbatimit të buxhetit.
2. Sistemi kontabilitetit dhe raportimit financiar duke përfshirë detyrimet e paprambetura dhe menaxhimin e aktiveve.
3. Sistemi krijimit dhe përdorimit të të ardhurave .
4. Sistemi prokurimeve/investimeve.
5. Sistemi pagesave në të cilën përfshihen edhe shpenzimet për bursat e studentëve.
6. Sistemi shpërndarjes së bursave dhe përjashtimet nga tarifat e shkollimit.
7. Sistemi i ligjshmërisë akademike, financiare dhe administrative.
8. Sistemi monitorimit të shërbimeve.
9. Sistemi menaxhimit të burimeve njerëzore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSHEM

VI. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RISQEVE

Plani strategjik 2024-2026 i veprimtarisë së auditimit të brendshëm bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Standardi i auditimit 2201 "Konsiderata të Planifikimit" dëshmon në mënyrë të qartë se aty ku menaxhimi ka ngritur një sistem funksional të menaxhimit të riskut audituesit duhet ta përdorin atë si bazë për kryerjen e vlerësimit të riskut.

Nga verifikimi rezultoi se Universiteti nuk ka hartuar regjistër risku efektiv dhe si burime për identifikimin e risqeve janë marrë në konsideratë raportet e mëparshme të auditimit të kryera nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, KLSH si dhe auditimet e brendshme nga sektori auditit.

Manuali i auditimit të brendshëm parashikon plotësimin e formateve standard (formati standard 1, 4 dhe 5), për përllogaritjen e riskut. Gjithashtu gjatë hartimit të planit strategjik për periudhën 2024-2026, vlerësimi i riskut është bërë mbi bazën e shqyrtimit të faktorëve, si: Rëndësia dhe madhësia e subjektit të audituar; materialiteti dhe kompleksiteti i transaksioneve; ndryshimi; mbikqyrje e dobët e menaxhimit; pikëpamjet e menaxhimit; frekuenca e auditimit, të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur dhe duke u dhënë prioritet sigurisht fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje.


Për sa theksuam më sipër është bërë i mundur identifikimi i një pjese të mirë të risqeve kryesore, sipas sistemeve si më poshtë:

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerezore

- Mungesa e rishikimit të rregullores së brendshme dhe përshtatja sipas organizimit strukturor të UV-së dhe kuadrit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Rregullorja për lidhjen e kontratave me punonjësit e UV-së, jo sipas përcaktimeve ligjore (Kodin e Punës) për sa i përket stafit administrativ dhe ndihmës akademik me karakter administrativ.
- Mungesa e trajnimeve.

Sistemi i prokurimeve publike

- Mungesa e zbatimit të aktiviteteve të kontrollit efektive në argumentimin e vlerës së kontratave dhe vendosjen e kriterëve.
- Mungesa e kontrolleve efektive gjatë zbatimit të kontratave.
- Mungesa e dokumentimit dhe gjurmës në procesin e furnizimit me karburant nëpërmjet sistemit elektronik.
- Mungesa e trajnimeve në fushën e prokurimit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSDHEM

- Mungesa e analizës dhe monitorimi sipas niveleve të menaxhimit për realizimin në kohë të prokurimeve.

-

Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar

- Mungesa e një programi për mbajtjen e kontabilitetit.
- Mungesa e procedurave të shkruara për lëvizjet e aktiveve jashtë institucionit.
- Mungesa e trajnimeve në fushën e kontabilitetit publik dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Sistemi i menaxhimit buxhetor

- Mungesa e praktikave dokumentare gjatë programimit të shpenzimeve buxhetore dhe lënia gjurmë gjatë këtij procesit.
- Mungesa e analizës dhe llogaritjes së kostos së veprimtarive për mirëpërcaktimin e fondeve për çdo zë buxhetor.
- Realizimi i investimeve në funksion të objektivave të institucionit.
- Mungesa e rishikimit të përshkrimeve të punës së punonjësve në funksion të rregullores.
- Ndarje jo e qartë e detyrave dhe përgjegjësisve për secilin punonjës.

VII. KUFIZIMET E AUDITIMIT

Kufizimet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit të brendshëm janë:

Rreziku i moszbulimit, i cili është rreziku që audituesi me përdorimin e procedurave thelbësore, nuk arrin të zbulojë një anomali.

Rreziku i mospërcaktimit të saktë dhe marrjes në konsideratë të nivelit të materialitetit.

Niveli i kualifikimit të stafit.

Kryerja e auditimeve me kërkesë të menaxhimit jashtë planit të miratuar mbetet ende risk për SAB.

Risqe që vijnë nga marrëdhënie me palët e audituara si vonesat në vënien në dispozicion të auditit të dokumentacionit dhe stafit të subjektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSHEM

VIII. PRIORITETET PËR VITET (1+2)

Prioritetet e njësisë së auditimit të brendshëm për 3 vitet e ardhshme në lidhje me përmirësimin e punës audituese do të jenë :


Veprimtaria audituese e Sektorit të AB në UV për vitet 2024-2026, do të përqendrohet në kryerjen e auditimeve, sipas programimit duke ruajtur frekuencën e auditimit si dhe duke konsideruar vlerësimin e nivelit të riskut.

Sipas vlerësimit të riskut, prioritet është auditimi i sistemeve të identifikuara me risk të lartë duke u orientuar në auditime mbi bazë risku, duke konsideruar dhe rekomandimet e adresuara nga auditimi i BE në plan veprimin e sjellë nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Një tjetër prioritet në punën audituese për vitet 2024-2026 do të jetë identifikimi dhe menaxhimi i riskut në kontrollat e brendshme të subjekteve që auditohen nëpërmjet rekomandimeve dhe ndjekjes së zbatimit të tyre si dhe përmirësimi i kapaciteteve të Sektorit të AB nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm.

Pergjegjës Sektori

Marjanthi Rrapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSHEM

PLANI VJETOR 2024

1. Zhvillimet aktuale të Njesisë së Auditimit të Brendshëm


Mbështetur në neni 116 të Ligji Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në vendimin e senatit Nr.8, datë 14.02.2019, "Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, njësia e auditimit të brendshëm në Universitetin "Ismail - Qemali" Vlorë, është e përbërë nga dy specialist dhe një përgjegjës

Spektori i AB për vitin 2023 ka planifikuar 5 misione auditimi të kombinuara. Plani vjetor 2023 identifikoi veprimtarinë e auditimit të brendshëm që u krye nga njësia në subjektet e identifikuar gjatë kësaj periudhe. Plani u hartua duke synuar pajtueshmërinë me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm. Programi vjetor I sektorit të auditimit është njehsuar në datë 31.10.2022 me Vendim Bordin Administrimi Nr.31 .Bazuar në planin vjetor 2023 u parashikuan 5 auditime :

- Sistemi I shpërndarjes së bursave dhe përjashtimet nga tarifat e shkollimit si dhe sistemi pagesave në të cilën përfshihen shpenzimet dhe bursat e studentit (realizuar)
- Sistemi I krijimit dhe përdorimit të të ardhurave. (debitorët) - (realizuar)
- Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, zyra e Financës (magazina) – në proces
- Vlerësimi përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera të BE.
- Vlerësimi detyrimeve të prapambetura

2. Prioritetet e auditimit të brendshëm për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, prioritetet e auditimit mbeten kryerja e angazhimeve të auditimit sipas planifikimit, për të mos mbartur vitin pasardhës angazhime të parealizuara në përmbushje të plotë të këtij planifikimi, duke u fokusuar në sisteme dhe fusha llogarie të cilat janë vlerësuar me risk të lartë. Përmirësimi i kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe forcimi i kapaciteteve të Sektorit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSHEM

3. Objektivat kryesore për vitin 2024

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektiv synon të ndihmojë subjektet e audituara të Universitetit "Ismail - Qemali", Vlorë të përmbushin objektivat e tyre.

Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë,

- Subjekte/fusha të vlerësuara me risk të lartë.
- Subjekte/fusha ku ka pasur ndryshime e zhvillime gjatë veprimtarisë së tyre.
- Kryerja e misionit të auditimeve të brendshme në përputhje me ligjin, manualin dhe standardet e AB.
- Realizimin e trajnimeve dhe ngritja profesionale specialisteve në njësinë e auditimit të brendshëm.

4. Programimi i llojit të angazhimit

Programimi i llojit të angazhimeve është bërë duke iu referuar organizimit të UV-së ku përfshihen dhe njësitë e varësisë si dhe duke njohur sistemet që operojnë brenda institucionit. Referuar formatit standard të Pasqyrës Nr.3, për vitin 2024 Sektori i AB ka planifikuar për të kryer 5 (pesë) angazhime auditimi të kombinuara, pra do të kryhen auditime të shërbimeve të sigurisë, mbi bazë sistemi, të cilat do të konsistojnë në ato fusha/sisteme që paraqesin risk të lartë dhe që kërkojnë më shumë kohë për të kryer auditimin.

Në Rektorat pavarësisht se në pasqyrën nr.1 janë identifikuar të gjitha sistemet, në planin vjetor janë parashikuar për auditim sistemet, konkretisht:

1. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
2. Sistemi i prokurimeve me vlerë të vogël;
3. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar
4. Sistemi ligjshmërisë

Gjatë vitit 2024, plani mund të ndryshojë me kërkesë të Titullarit të Institucionit apo Bordit Të Admnistrimit , si dhe nga njësia e auditit do të ofrohen shërbime sigurie dhe këshillimi nëqoftëse do të kërkojnë apo do të jënë të nevojshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SEKTORI I AUDITIT TE BREND SHEM

Në çdo program angazhimi, pavarësisht se nuk është përfshirë në Pasqyrën nr.1 dhe Pasqyrën nr.2 bashkëlidhur, një prej drejtimeve të auditimit do të jetë Vlerësimi i komponentëve të sistemit të mënaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjithashtu gjatë vitit Sektori i AB do të kryej monitorimin e rekomandimeve në rrugë shkresore si dhe në auditimet e radhës.

• Planifikimi i kostos për vitin 2024

Kostoja e auditimit është përlogaritur sipas zërave të përcaktuar në pasqyrën Nr.5, duke marrë parasysh të dhënat aktuale mbi numrin e audituesve si dhe treguesit aktual mbi pagat dhe sigurimet shoqërore si dhe shërbimet e tjera si pajisje kompjuterike, kancelari e shtypshkrime, për 3(tre) punonjës (1 përgjegjës dhe dy specialist).

• Planifikimi i burimeve për vitin 2024

Planifikimi i burimeve të auditimit për vitin 2024 është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion, pra me tre punonjës.

Referuar përlogaritjes së burimeve sipas Pasqyrës Nr.5, për vitin 2024 numri i ditëve të planifikuara është 206 ditë/person dhe numri i auditimeve është 5 auditime gjithsej, të cilat do të synohet të realizohen.

Gjatë kryerjes së angazhimeve vjetore nga struktura e AB do të synohet ruajtja e qëllimit të auditimit nëpërmjet ruajtjes së parimit të pavarësisë funksionale dhe organizative, dhe në asnjë rast nuk mund të ngarkohet me detyra të tjera operative brenda subjektit, që nuk kanë lidhje me funksionin e auditimit, ashtu sikurse nuk mund të jenë në përbërje të strukturave të tjera operative të subjektit.

• Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Një nga prioritetet e Sektorit të AB për vitin 2024 është dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore të Sektorit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm. Për këtë qëllim janë përcaktuar nevojat dhe janë identifikuar temat për trajnim sipas pasqyrës Nr.4.

Organizimi i një trajnimi në lidhje me auditimin e avancuar mbi bazë risku dhe auditimi i rasteve të mashtrimit për audituesit e brendshëm do të ishte shumë i dobishëm dhe me interes për stafin e Sektorit të AB.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I AUDITIT TE BREND SHEM

• **Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë**

Standardi 1300 – Programi i Siguri dhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Në fillim të vitit 2024 do të kryhet dhe sigurimi i cilësisë së brendshme të njësisë së Auditimit në zbatim të programit të cilësisë hartuar nga Njësia dhe miratuar me nr 159 datë 01.02.2022.

Bashkangjitur janë pasqyrat të cilat pasqyrojnë me në detaje aktivitetin e punës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, si dhe planifikimi strategjik për vitet (1+2) 2024 - 2026. Gjatë vitit do bëhen ndryshime në planin fillestar nëse është e nevojshme duke marrë miratimin e Bordit të Administrimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Përgjegjës Sektori

Marjanthi Rrapaj

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSSHËM
Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë

Pasqyra i

Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjithë subjektet që duhet të auditohen nga NJAB

NR	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	Vlerësimi i përgjithshëm i riskut		
			I larte	I mesem	I ulet
	1	2	3	4	5
1	Rektorati	Sistemi menaxhimit të riskut	x		
		Sistemi Prokurimeve	x		
		Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave		x	
		Sistemi programimit dhe zbatimit të buxhetit		x	
		Sistemi ligjshmërisë akademike, financiare dhe administrative.	x		
		Sistemi menaxhimit të burimeve njerëzore.	x		
		Sistemi pagesave.		x	
		Sistemi kontabilitetit dhe raportimit financiar	x		

Përgjegjese Sektori
Marjanthi Rrapaj



Përfundimi i strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2024-2026

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
NR	Viti i planifikuar	Niveli i riskut	Viti i planifikuar +1 2025	Niveli i riskut	Viti i planifikimit + 2026	Niveli i riskut
	1	2	3	4	5	6
1	Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse, sektori Prokurimeve	I lartë	Fondet IPA	I mesëm	Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse, sektori Prokurimeve	I ulët
2	Drejtoia e komunikimit dhe burimeve njerëzore	I lartë	Praktikat e dokumentave gjatë programimit të shpenzimeve buxhetore dhe lënia gjurmë gjatë këtij procesit	I mesëm	Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse	I ulët
3	Sektori juridik	I lartë	Praktika e vendosjes së të gjitha kontrolleve në shërbimet që gjenerojnë të ardhura	I mesëm	Drejtoia e Ciklit të parë dhe të dytë e edukimit (debitoret)	I ulët
4	Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse, sektori shërbimeve	I lartë	Vlerësimi detyrimeve të prapambetura	I mesëm	Sektori I ulët	I ulët
5	Fakultetet, puna administrative në bazë të rregullores	I lartë	Mbingarkesat	I mesëm	Fondet IPA	I ulët
	SHUMA	1		2		3

Përfundimi i
Marjanthi Rrapaj

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2024

NR	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime gjithsej (4,1+ 4,2 + 4,3 + 4,4 + 4,5 + 4,6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e këshillimit	Grupi i A: ditimit (nr, auc tues)
				A, të përputhshmërisë	A, të performancës	Financiare	A, Tek, Informacionit	A, të kombinuara		
a,	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1		Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse, sektori Prokurimeve		1						
2		Drejtoia e komunikimit dhe burimeve njerëzore		1						
3		Sektori juridik		1						
4		Drejtoia e Shërbimeve Mbështetëse, sektori shërbimeve					1			
5		Fakultetet, puna administrative në bazë të rregullores		1						
	SHUMA			4			1			

Përgjegjës Sektori
Marjanthi Rrapaj



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSSHËM

Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë

Pasqyra 4

Planifikim i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2024

NR	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr, personave)	Periodha (vitet)	Kohëzgjatja e trajnimit (në ditë)
a,	1	2	3	4
	Metodologjite e auditimit	3	Nentor	1
	Teknikat e auditimit	3	Nentor	2
	Vleresimi i riskut, identifikimi dhe menaxhimi tij	3	Nentor	1
	Auditim performance	3	Nentor	1
	SHUMA			5

Pergjegjes Sektori
Marjanthi Rrapaj



Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024

000/L ekë

NR	BURIMET E PLANIFIKUARA			BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e burimeve njerëzore të NJAB	Ditë për tregues (gjithsej)	Përlogaritja e burimeve	Buxheti Gjithsej	Plani
	1	2	3	1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52jave x 5 dite x 3 person	Buxheti gjithsej	226800
2	Pushime vjetore	60	20 dite per person	Paga dhe Sig. Shoqërore	216800
3	Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	24	8 dite	Shpenzime udhëtimi & dieta	10000
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	5	Të tjera	0
5	Angazhime në trajnime	21	7	Numri i punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/trajnime	12	4	Kosto e planifikuar për (1/3)	72266
7	Rezerva të planifikuara (të papritura)	30	10		
	Totali	618	206 ditë/person		

Pergjegjes Sektori
Marjanthi Rrapaj

